

# Seanca 3 KP-E: Programi arsimor për KSP-në në Maqedoninë e Veriut

Zorica Bozhinovska Lazarevska Ph.D, CA

5 dhjetor 2024



**CFRR** >>  
Centre for Financial  
Reporting Reform




**PULSAR** 

Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR Program is co-funded by:

 Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

# Kuadri i regulator për kontabilitetin në sektorin publik



## Ligji për kontabilitetin e buxhetit dhe përdoruesve të buxhetit

Përdoruesit e buxhetit kanë për detyrim të mbajnë dokumentacionin kontabël në përputhje me kërkesat e Ligjit për kontabilitetin e buxhetit dhe përdoruesve të buxhetit (2002-2013) dhe aktet nënligjore përkatëse, përfshirë parimet dhe standardet kontabël të miratuara.

Standardet e kontabilitetit të cilat duhet t'i përdorin buxhetet dhe përdoruesit e buxhetit në Maqedoni, janë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP).

Megjithatë, deri tani, në sektorin publik është përkthyer dhe përdorur vetëm SNKSP-ja me bazë monetare.

# Formimi për certifikimin e kontabilistëve publikë në Maqedoninë e Veriut



3

## Formimi për certifikimin e kontabilistëve publikë (FCKP)

- Program kualifikimi profesional i njohur në nivel ndërkombëtar për kontabilistët e sektorit publik, që përfshin formim në klasë, provime dhe veprimtari shtesë të zhvillimit të kapaciteteve.
- FCKP-ja është zhvilluar nga Instituti i Autorizuar i Financave dhe Kontabilitetit Publik (CIPFA) dhe është përshtatur nga CEF, Lubjanë, Slloveni.

# Formimi per certifikimin e kontabilisteve publike (FCKP)



4

## Modulet e certifikatës

- Kontabiliteti i drejtimit
- Kontabiliteti financiar
- Financat publike qendrore, legjislacioni kontabël dhe tatim-taksat

## Modulet e diplomës

- Auditimi dhe siguria
- Drejtimi financiar
- Administrim i biznesit dhe ndryshimit
- Raportimi financiar në sektorin publik

# Formimi për certifikimin e kontabilisteve publike (FCKP)



5

<b>Brezi</b>	<b>Kontabilistë që kanë marrë certifikatë</b>	<b>Kontabilistë që kanë marrë diplomë</b>
<b>Brezi I, 2008/2011</b>	25	23
<b>Brezi II, 2012/2013</b>	24	-
<b>Brezi III, 2014/2016</b>	10	9
<b>Brezi IV, 2020/2021</b>	19	-
<b>Brezi V, 2022/2023</b>	-	10
<b>Gjithsej</b>	<b>78</b>	<b>42</b>



# Universiteti "Sh. Kiril dhe Metodius", Fakulteti Ekonomik, Shkup



## Kryeson në arsim -

- 74 vjet traditë
- Personel akademik tejet profesional dhe i njohur
- Tërheq studentët më të mirë
- Krijon profesionistët më të respektuar në biznes dhe ekonomi


Fakulteti Ekonomik, Shkup, Universiteti “Sh. Kiril dhe Metodius” në Shkup është ofruesi më i rëndësishëm dhe më i respektuar i arsimit të lartë profesional për biznes dhe ekonomi në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Fakulteti është themeluar nga Qeveria e Maqedonisë më 14 nëntor 1950, me qëllim “rritjen teorike dhe përgatitjen praktike të profesionistëve ekonomikë tejet të kualifikuar”.

# Fakulteti Ekonomik, Shkup, shkurtimisht



8





# Program universitar – (cikli i parë) – kontabilitet dhe auditim



9

Lëndët e detyrueshme

Semestri 1

- Hyrje në ekonomi;
- Matematikë për ekonomi
- Parimet e kontabilitetit

Semestri 2

- Statistika për biznes dhe ekonomi,
- E drejta tregtare,
- Bazat e biznesit elektronik

Semestri 3

- Hyrje në administrim,
- Parimet e marketingut
- Kontabiliteti financiar

Semestri 4

- Kontabiliteti i drejtimit 1
- Komunikim biznesi
- Tregjet dhe institucionet financiare

# Program universitar – (cikli i parë) – kontabilitet dhe auditim



10

Lëndët e detyrueshme

Semestri 5

- raportimi financiar i shoqërive tregtare
- Sistemet informatike të kontabilitetit
- Drejtimi financiar

Semestri 6

- Auditimi;
- Kontabiliteti i drejtimit 2
- Administrimi i rreziqeve

Semestri 7

- Kontabiliteti shtetëror dhe kontabiliteti i organizatave jofitimprurëse
- Analitika e të dhënave të biznesit
- Financat publike

Semestri 8


- Analiza e pasqyrave financiare
- Auditimi i brendshëm
- Kontabiliteti ndërkombëtar

Lëndë me zgjedhje  
Sistemet e kontrollit kontabël

# Program universitar – (cikli i parë) – kontabilitet dhe auditim



11



# Program universitar – (cikli i dytë) – kontabilitet dhe auditim



12

## Lëndët e detyrueshme

- Auditimi dhe siguria
- Analiza e pasqyrave financiare
- Raportimi financiar
- Kontabiliteti i drejtimit strategjik

## Lëndë me zgjedhje

- Metodatat e kërkimit shkencor në kontabilitet
- Këqyrja e krimit financiar
- Auditimi shtetëror
- Kontabiliteti fiskal
- Accounting Information Systems and Technologies
- Corporate Governance
- Drejtimi financiar
- Kontabiliteti shtetëror dhe kontabiliteti i organizatave jofitimprurëse

# Program universitar – (cikli i dytë) – kontabilitet dhe auditim



13



Exemption Accreditation

Think Ahead **ACCA**

This is to certify that

**Ss. Cyril and Methodius University in Skopje**

**MSc Accounting and Auditing (Second Cycle Degree Programme)**

is an

ACCA Accredited Programme

Valid from: 01 January 2023

Valid until: 31 December 2027

**Ann Lamb**  
Director – Professional Qualifications

**Association of Chartered Certified Accountants**

This certificate remains the property of ACCA and must not in any circumstances be copied, altered or otherwise defaced. ACCA retains the right to demand the return of this certificate at any time and without giving reason.

# Programi i ndërgjegjësimit akademik për auditimin e brendshëm - IAEP



14

- Fakulteti Ekonomik, Shkup, nëpërmjet Departamentit të Kontabilitetit dhe Auditimit, konkretisht nëpërmjet lëndës “Auditim i brendshëm”, renditet në programin e njohur të ndërgjegjësimit akademik për auditimin e brendshëm të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IAB).
- Programi i ndërgjegjësimit akademik është krijuar për të njohur shkallët e ndryshme të angazhimit dhe punës që bëjnë institucionet e arsimit të lartë për t’i pajisur studentët me informacionet dhe aftësitë e nevojshme për përzgjedhjen e një karriere në fushën e auditimit të brendshëm.



**AWARENESS SCHOOL**



# OPEN CALL

for participants



## BRIDGING THE GAP: NON-TRADITIONAL MAJORS AND THE FUTURE OF INTERNAL AUDITING SUSTAINABILITY

4 workshops

Duration: February - May, 2024

Internal audit function visit in a prominent corporation

Participants: 30 + students

Research project competition

Tutors: 7+



The Institute of  
**Internal Auditors**



Internal Audit  
**FOUNDATION**



Internal Auditing Education Partnership



*This project was funded by an Internal Auditing Education Partnership (IAEP) Program Grant supported by the Internal Audit Foundation's Academic Fund.*

<https://www.theiia.org/en/internal-audit-foundation/>



**Në cilat njohuri dhe aftësi duhet të përqendrohen programet arsimore të kontabilitetit dhe auditimit, për të përgatitur brezin e ardhshëm të kontabilistëve profesionistë?**



# Arsimi për OZHQ-të/MSQ-në: përtej programit tradicional për kontabilitet dhe auditim



17

- **Profesionisti kontabël do të luajë një rol kyç në ofrimin e informacioneve dhe shërbimeve cilësore në lidhje me qëndrueshmërinë.**
- **Vështirësitë në arsimin për OZHQ-të/MSQ-në për kontabilistët**
  1. **Një botë e cila ndryshon me shpejtësi:** Natyra dinamike e standardeve të MSQ-së kërkon përditësime të vazhdueshme të programit mësimor.
  2. **Lidhja mes teorisë dhe praktikës:** Vështirësi mbetet përkthimi i dijeve teorike mbi MSQ-në në strategji praktike biznesi.
  3. **Kapërcimi i mendësive tradicionale:** Për profesionistët me përvojë, që i kanë rrënjët në paradigmat tradicionale të biznesit, përqafimi i MSQ-së mund të kërkojë një ndryshim jo të vogël të mendësisë.

# Përgatitja e kontabilistëve profesionistë për qëndrueshmërinë: çfarë kemi e çfarë na duhet, IFAC



18

- Në botimin “**Përgatitja e kontabilistëve profesionistë për qëndrueshmërinë: Çfarë kemi e çfarë na duhet**”, IFAC e vë theksin te rëndësia që kanë kontabilistët si profesionistë që **mendojnë në sisteme** dhe që njohin **lidhjen mes financave dhe qëndrueshmërisë**.
- Qëndrueshmëria nuk mund të shihet si e izoluar si temë. Kontabilisti profesionist duhet të mbajë parasysh ndikimin e qëndrueshmërisë globale në modelet tregtare, zinxhirët e vlerës dhe strategjitë, si edhe në drejtimin e brendshëm, rreziqet dhe mundësitë.
- **Ndërsa profesioni kontabël përgatitet për të përmbushur kërkesat për informacion cilësor lidhur me qëndrueshmërinë, kontabilistët profesionistë, akademikët dhe ofruesit e arsim-formimit duhet të mendojnë si të plotësojnë boshllëqet në programet e arsim-formimit kontabël.**
- Lajmi i mirë është se shumë nga ato që bëjnë tashmë kontabilistët profesionistë mund të vlejnë për shërbimet e lidhura me qëndrueshmërinë. **Tema dhe vështirësi të tjera të reja të lidhura me qëndrueshmërinë do të kërkojnë mënyra të reja të menduari dhe të punuari.**

# Korniza e arsimit për qëndrueshmërinë e IFAC-ut: katër fusha kryesore të fokusit për kontabilistët profesionistë



19

Mendjemprehtësia tregtare

Kompetenca e sjelljes

Ekspertiza teknike

Sjelljet etike

# Korniza e arsimit për qëndrueshmërinë e IFAC-ut: katër fusha kryesore të fokusit për kontabilistët profesionistë



20

## ● MENDJEMPREHTËSIA TREGTARE

### ○ NA NEVOJITET:

- Të mendojmë në sisteme dhe të marrim parasysh ndikimin e qëndrueshmërisë globale në modelet tregtare, zinxhirët e vlerës dhe strategjitë.
- Të njohim lidhjen e rreziqeve dhe mundësive financiare dhe të qëndrueshmërisë.
- Të vlerësojmë ndikimin për drejtimin e brendshëm, rreziqet dhe administrimin e rezultateve.
- Të sigurojmë për nivelet drejtuese të dhëna dhe informacione mbi qëndrueshmërinë, në mbështetje të vendimmarrjes.
- T'u vëmë në dispozicion informacione cilësore dhe të dobishme për vendimmarrje palëve të jashtme të interesit

# Korniza e arsimit për qëndrueshmërinë e IFAC-ut: katër fusha kryesore të fokusit për kontabilistët profesionistë



21

## ● KOMPETENCA E SJELLJES

### ○ NA NEVOJITET:

- Të zbatojmë aftësitë analitike dhe njohuritë kontabël për llojet e reja të dhënave dhe kërkesat e reja të raportimit.
- Të përdorim të menduarit kritik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve për të analizuar në mënyrë efektive skenarët e ardhshme, përfshirë rreziqe dhe pasiguri, dhe për të vlerësuar alternativat.
- Të përshtatemi dhe do të jemi të zhdërvjellët në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të reja në përgjigje të aktiviteteve të lidhura me qëndrueshmërinë.
- Të përmirësojmë më tej aftësitë e bashkëpunimit për të punuar në mënyrë efektive në ekipe shumëdisiplinore dhe me një gamë më të gjerë ekspertësh.
- Të komunikojmë qartë dhe efektivisht me një gamë më të gjerë palësh interesi të brendshme dhe të jashtme.

# Korniza e arsimit për qëndrueshmërinë e IFAC-ut: katër fusha kryesore të fokusit për kontabilistët profesionistë



22

## ● EKSPERTIZA TEKNIKE

### ○ NA NEVOJITET:

- Të kuptojmë dhe përdorim standarde dhe kërkesa të reja për raportimin dhe sigurinë lidhur me qëndrueshmërinë.
- Të krijojmë mënyra të reja për të matur rezultatet, përfshirë metrikë dhe objektiva të mbështetur në shkencë.
- Të analizojmë lloje të reja të grupeve të të dhënave dhe skenarëve lidhur me qëndrueshmërinë, për një vendimmarrje mbështetur në informacione.
- Të projektojmë, zbatojmë dhe vlerësojmë sisteme, procese dhe sisteme kontrolli për raportimin e qëndrueshmërisë.
- Të përdorim gjykimin dhe analizojmë materialitetin për kontekstin e qëndrueshmërisë.
- Të nxjerrim informacione shpjeguese dhe të dhëna cilësore të qëndrueshmërisë që janë të dobishme për vendimmarrje

# Korniza e arsimit për qëndrueshmërinë e IFAC-ut: katër fusha kryesore të fokusit për kontabilistët profesionistë



23

## ● **ETIKA DHE VLERA PROFESIONALE**

### ○ **NA NEVOJITET:**

- Të përdorim standardet e ardhshme të rishikuara dhe të reja të etikës për raportimin dhe sigurinë lidhur me qëndrueshmërinë.
- Të mbajmë parasysh rreziqet etike në kuadër të qëndrueshmërisë, përfshirë gjatë punës me ekspertë dhe të tjerë.
- Të përdorim gjykimin profesional dhe skepticizmin gjatë hartimit ose dhënies së sigurisë për informacionet shpjeguese të lidhura me qëndrueshmërinë.

# Kompetencat e arsimit për zhvillim të qëndrueshëm (AZHQ)



24

Korniza Lozano, Merrill, Sammalisto, Ceulemans, and Lozano (2017) përfshin 12 kompetenca, që quajtura si “Kompetencat e arsimit për zhvillim të qëndrueshëm (AZHQ)”, ku përfshihen

1) të menduarit me sisteme,

2) puna ndërdisiplinore,

3) të menduarit parapritës,

4) drejtësia, përgjegjësia dhe etika,

5) të menduarit kritik dhe analiza,

6) raportet dhe bashkëpunimi mes njerëzve,

7) empatia dhe ndryshimi i këndvështrimit,

8) komunikimi dhe përdorimi i mediave,

9) veprimi strategjik,

10) përfshirja personale,

11) analiza dhe vlerësimi dhe

12) toleranca për paqartësinë në të kuptuar.



# Përfitimet kryesore për Fakultetin Ekonomik nga programi PULSAR



25

- Akreditimi në ACCA
- Diskutime që na kanë frymëzuar të bëjmë kërkime shkencore
- Prezantime mbi tema aktuale të kontabilitetit të sektorit publik të cilat na i kanë zgjeruar horizontet shkencore
- Lektorë të jashtëzakonshëm nga IFAC, INTOSAI, EFRAG etj.
- Vendosja e kontakteve me kolegë nga universitete të tjera dhe nga institucione të sektorit publik

“Forcimi i progresit të qëndrueshëm: Analizë e auditimeve të performancës dhe praktikave të dhënies së informacioneve të institucioneve të kontrollit të lartë të shtetit”, *Journal of Public Budgeting, Accounting & Financial Management*, (25 qershor 2024), DOI: 10.1108/JPBAFM-06-2023-0092

- Qëllimi

- Ky material teknik ka dy qëllime. Së pari, të shihet dhënia e informacioneve nga institucionet e kontrollit të lartë të shtetit për auditimet e performancës në lidhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, duke u përqendruar në katër vende të Ballkanit: Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Sllovenia. Së dyti, të shihet nëse anëtarësimi në Bashkimin Evropian, së bashku me miratimin dhe zbatimin e legjislacionit të unifikuar dhe praktikave më të mira të BE-së në sferat shoqëro-ekonomike dhe politike ndikon në nivelin e praktikave të dhënies së informacioneve në auditimin e OZHQ-ve dhe qasjeve kombëtare për auditimin e temave që kanë të bëjnë me OZHQ-të.

- Konstatime

- Konstatimet nënvizojnë se KLSH-ja e Sllovenisë spikat për dhënien e informacioneve të plota në raportet vjetore në lidhje me OZHQ-të apo raportimin e qëndrueshmërisë. Ky institucion tregon edhe një nivel të lartë të auditimit të performancës për temat e OZHQ-ve. Menjëherë pas tij vijnë KLSH-të e Maqedonisë dhe Kroacisë, të cilat gjithashtu tregojnë ecuri të dallueshme në këto fusha. Në dallim prej tyre, KLSH-ja e Malit të Zi shfaq nivelin më të ulët të dhënies së informacioneve dhe ka kryer më pak auditime të performancës në lidhje me OZHQ-të. Gjithashtu, studimi tregon se nuk ka korrelacion të ndjeshëm midis anëtarësimit në BE dhe shkallës së dhënies së informacioneve për OZHQ-të në raportet vjetore të KLSH-ve dhe nivelit të auditimit të performancës.



# Fushat kryesore për zhvillim dhe hapat në vijim në kuadër të PULSAR II



27

- Formim i instruktorëve me fokus në një kornizë solide të raportimit dhe sigurisë për qëndrueshmërinë (CSRD, SNRF S1, SNRF S2, SNA 5000, SNE 2, SNE 3, SNE 4 etj.)
- Formim i instruktorëve për përfshirjen e Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit të IFAC-ut në programet mësimore të kontabilitetit dhe auditimit
- Formim i instruktorëve për zhvillimin e shprehive të tërthorta në brezin e ardhshëm të studentëve – përdorimi i skepticizmit profesional, të menduarit kritik dhe zgjidhja e problemave, të menduarit me sisteme, përshtatshmëria dhe fleksibiliteti, shprehitë e komunikimit etj., me anë të shembujve dhe rasteve studimore
- Marrja e përvojave nga universitete të njohura të BE-së lidhur me përdorimin e digjitalizimit në studimin e kontabilitetit dhe auditimit
- Seminar pune për zhvillimin dhe zbatimin e qasjet me disa palë interesi në arsim
- Zbatimi i mënyrave novatore didaktike dhe mësimore në kontabilitet dhe auditim



# Faleminderit!



**CFRR** >>  
Centre for Financial  
Reporting Reform




Public Sector Accounting and Reporting Program

---

PULSAR Program is co-funded by:

 Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
**State Secretariat for Economic Affairs SECO**

---